



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.151

14 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.703, datë 5.10.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kodovjat të qarkut të Elbasanit	6951
Vendim i KM nr.706, datë 12.10.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zagorie të qarkut të Gjirokastrës	6952
Vendim i KM nr.707, datë 12.10.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dajç të qarkut të Lezhës	6953
Udhëzim i MF nr.23, datë 25.10.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.25, datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre	6954
Udhëzim i MF nr.24, datë 7.11.2011	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.6.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar	6955
Udhëzim i MF nr.25, datë 8.11.2011	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar ...	6956
Udhëzim i MB nr.394/4, datë 11.11.2011	Për një ndryshim në udhëzimin nr.308, datë 8.5.2009 “Për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve”, të ndryshuar.	6959
Urdhër i MTKRS nr.249, datë 26.10.2011	Për revokimin e urdhrin nr.92, datë 27.2.2009 “Për licencimin e agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të prodhuesve shqiptarë të fonogrameve dhe videogrameve (AMI)”	6960

Vendim i ERE nr.99, datë 30.9.2011	Mbi miratimin e studimit për borxhin e keq	6960
Vendim i ERE nr.100, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Lanabregas	6962
Vendim i ERE nr.101, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	6963
Vendim i ERE nr.102, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me seri PM09SH, nr.77, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.23, datë 25.3.2009 për shoqërinë KESH sh.a.....	6964
Vendim i ERE nr.103, datë 17.10.2011	Për kualifikimin e impianteve prodhuese (hec Faqekuq 1 dhe hec Faqekuq 2) si burim i rinovueshëm energjie	6965
Vendim i ERE nr.104, datë 17.10.2011	Për transferimin e asetit të “Selca Energy”, përkatësisht “Hec-Selca” (lënie peng të asetit si kolateral pranë Bankës Credins)	6965
Vendim i ERE nr.105, datë 17.10.2011	Për licencimin e shoqërisë “ERMA MP” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	6966
Vendim i ERE nr.106, datë 17.10.2011	Për licencimin e shoqërisë “ERMA MP” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	6967

VENDIM
Nr.703, datë 5.10.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KODOVJAT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kodovjat të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kodovjat të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.312, datë 25.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kodovjat, të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kodovjat për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kodovjat	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
361-375	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (pasuritë: me nr.368, ndërtesa është e prishur, me nr.374, në të njëjtën godinë edhe çerdhja, me nr.375 në të njëjtën godinë çerdhja dhe ambulancë)	Në pronësi
376-378	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive (janë dhënë me qira nga komuna)	Në pronësi
379-384	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik (pasuritë me nr.379, 383 janë zënë nga privatë, ndërsa pasuria me nr.384 në të njëjtën godinë me kopshtin)	Në pronësi
385,386,388,389,391,395-411,440-446,447-453,461	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
387,462-472	Varrezat publike	Në pronësi
416-439,454-456,458,459	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi



457	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
390,475,476	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) Sipërfaqja 99 ha e cila është në fshatrat Bërsnik i Sipërm dhe Bërsnik i Poshtëm është dorëzuar në AKKP	Në përdorim
538-652,656-693	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

VENDIM
Nr.706, datë 12.10.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ZAGORIE TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zagorie të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 511 (pesëqind e njëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Zagorie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Zagorie

Lidhja 1

Numra rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-15	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
25	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
16	Prona që përdoren për realizimin e programeve shëndetësore	Në pronësi
18-23	Varrezat publike	Në pronësi

41-69	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
258-335	Infrastrukturë (sheshe), rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
221-223, 225, 227, 228, 230,232, 234, 235, 237, 239, 240, 242	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
224, 226, 229, 231, 233, 236, 238, 241, 243, 248, 252, 257	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr.707, datë 12.10.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS DAJÇ TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dajç të qarkut të Lezhës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 42 (dyzet e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dajç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dajç

Lidhja nr.1

Numra rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-8	Varreza publike	Në pronësi
9	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shërbimet publike	Në pronësi
10-13, 153-154	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
14-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
22	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi



23-46	Prona që përdoren për ushtrimin e profesioneve në fushën e zhvillimit ekonomik (objekte bujqësore)	Në pronësi
50, 54, 58, 61, 64, 68, 71, 73, 76, 79, 83, 87, 91, 94, 120	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive)	Në pronësi
97-111,145-152	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
116-119	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim DAMT e komunës, së bashku me atë të qarkut Lezhë ka vënë në dispozicion të AKKP-së nga kjo komunë sipërfaqen prej 48.57 ha. Kjo sipërfaqe është dorëzuar në AKKP bashkë me dokumentacionin shoqërues
121-130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

UDHËZIM
Nr.23, datë 25.10.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.25, DATË 30.11.2007 “PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË KËMBIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, me propozimin e komisionit *ad-hoc*, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pika 13 e udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:
“13. Vlera e një autoveture do të gjendet në tabelë (QUATTRORROUTE) duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast vlera doganore nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit të gjendur në tabelë.”.
2. Pika 15 e udhëzimit ndryshohet me këtë përmbajtje:
“15. Kur për autoveturën që vlerësohet në buletin nuk gjendet modeli, vlerësimi të bëhet duke u nisur nga modeli dhe cilindrata më e afërt. Në këtë rast, vlera nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit që jepet në tabelë.”.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.24, datë 7.11.2011

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 30.6.2006 “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.5, datë 30.6.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2.3.10, fjalia e fundit “Drejtoria rajonale e tatimeve njofton QKR-në për lëshimin e këtij vërtetimi”, zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

“Këtë vërtetim, individit ia bashkëlidh kërkesës për aplikim në QKR për zmadhim kapitali në formë monetare. Mungesa e tij e bën aplikimin të pavlefshëm dhe QKR-ja nuk procedon për regjistrimin e zmadhimit të kapitalit në formë monetare.”.

2. Pika 3.13.2 riformulohet me përmbajtje, si më poshtë:

“3.13.2 Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, gjatë periudhës tatimore, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve të kësteve të tatim-fitimit të paracaktuara nga organi tatimor.

Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e parapagimit të tatim-fitimit në më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi duhet të paguajë interes, në masën 5% mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor sipas deklaratës së tatim-fitimit vjetor dhe shumës së tatim-fitimit të parapaguar gjatë vitit.

Shembull.

Parapagimi i tatimit mbi fitimin për vitin në vazhdim, bazuar në dy vitet paraardhëse, është për shumën 2,000,000 lekë, i ndarë sa më poshtë:

Këstet e llogaritura për muajt janar-prill 400,000 lekë (4 muaj x 100,000);

Këstet e llogaritura për muajt maj-dhjetor 1,600,000 lekë (8 x 200,000).

Tatimpaguesi, bazuar në argumentet e dhëna, ka ulur në zero këstet e muajit nëntor-dhjetor për shumën $2 \times 200,000 = 400,000$ lekë. Pra parapagimi total i tatim-fitimit për vitin në vazhdim ndryshon nga 2,000,000 lekë në 1,600,000 lekë.

Nëse sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, tatimpaguesi ka deklaruar tatimin mbi fitimin në shumën 2,100,000 lekë, pra për më shumë se 10% ($2,100,000/1,600,000$), kundrejt parapagimit të tatimit mbi fitimin të derdhur, duhet të paguhet interes në masën 5% mbi diferencën 500,000 lekë ($2,100,000 - 1,600,000$ lekë), pra duhet të paguajë shumën 25,000 lekë.

Ky interes duhet të deklarohet në rubrikën 26 (dënime/interesa për vonesa) të formularit të deklaratës vjetore të tatim-fitimit).

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



UDHËZIM
Nr.25, datë 8.11.2011

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2.1.1 “Ndryshime që kërkojnë çregjistrim”:

Pika “d” shfuqizohet.

Pika “e” ndryshon me përmbajtje, si më poshtë:

“e) Organet tatimore çregjistrojnë çdo person që as nuk është i detyruar e as ka të drejtë të regjistrohet, me efekt nga data kur personi është regjistruar. Këto organe refuzojnë të regjistrojnë çdo person që as nuk është i detyruar dhe as ka të drejtë të regjistrohet.”.

2. Në pikën 2.2.1, paragrafi i dytë, që fillon nga “Kur qarkullimi bie.....” deri në fund të paragrafit dhe paragrafi i tretë që fillon nga “ kur personi i tatueshëm heq dorë.....” deri në fund të paragrafit, shfuqizohen.

3. Në pikën 2.2.2 “Dispozita të tjera për çregjistrimin”, paragrafi 2 ndryshon në përmbajtje, si më poshtë:

“Personat e tatueshëm që çregjistrohen sipas pikës “e” të paragrafit 2.1.1 të këtij udhëzimi, nuk detyrohen të llogarisin TVSH-në mbi gjendjen e mallrave stok.”.

4. Pika 6.2. “Furnizimi i shërbimeve nga jashtë vendit”, pas shembullit të parë shtohen paragrafët:

“Në rastet kur personi Z (tatimpagues TVSH-je në Shqipëri), krahas shitjeve të tatueshme ka edhe shitje të përjashtuara, ky person duhet të zbatojë kreditimin e pjesshëm të TVSH-së në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

Në rastin kur personi Z, person i tatueshëm në Shqipëri, kryen vetëm furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, ky person nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH-në e autofaturës së lëshuar në zbatim të këtij udhëzimi.

Në rastin kur shërbimi që merr Z, person i tatueshëm në Shqipëri nga X, person i tatueshëm jashtë Shqipërisë, është furnizim shërbimi i përjashtuar në Shqipëri në zbatim të ligjit “Për TVSH-në”, për këtë furnizim shërbimi nuk zbatohen dispozitat e nenit 15 pika 5 të ligjit, pra ky shërbim nuk autofaturohet.”

Pas shembullit të dytë shtohet paragrafi me përmbajtjen, si më poshtë:

“Personi i tatueshëm jo rezident në Shqipëri, i cili kryen shërbime, vendi i furnizimit të të cilave është në Shqipëri dhe për rrjedhojë detyrimi për të paguar TVSH-në lind në Shqipëri, në zbatim të nenit 55 të ligjit i kërkohet të emërojë përfaqësuesin e tij tatimor. Detyrimi i personit të tatueshëm jorezident, për t’u regjistruar me anë të një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri, zbatohet pavarësisht nëse vlera e furnizimit të shërbimit kalon ose jo kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar.”.

5. Në fund të pikës 7.2 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tregtisë së energjisë elektrike, në përcaktimin e një furnizimi me pagesë të reduktuar, organi tatimor nuk duhet të ndërhyjë në vlerën e taksueshme të furnizimeve të zakonshme të diktuar nga kushtet dhe çmimet e imponuara të tregut (vlera e tregut për furnizimet e tatueshme) në kohën e kryerjes së tyre (p.sh. në kohën kur lidhen kontratat përkatëse apo

kryhen transaksionet), në bazë të kontratave të lidhura më parë (kontrata *forward*), pavarësisht nëse realizohet fitim për tatimpaguesin apo jo. Në këtë rast, organi tatimor duhet të konsiderojë të gjitha rrethanat e transaksionit dhe natyrës së aktivitetit tregtar të taksapaguesit, si për shembull rasti i subjekteve të tregtisë së energjisë elektrike, ku vlera e tatueshme do të jetë e përcaktuar në bazë të vlerës së paguar sipas nenit 27 paragrafi 1 i ligjit “Për TVSH-së” dhe që reflektohet në dokumentacionin përkatës të tatimpaguesit.”.

6. Pas pikës “8.8.2 Furnizimi i barnave” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në kuptim të kësaj pike me barna kuptohen barnat për konsum njerëzor dhe barnat që përdoren për kafshët.”.

7. Pas pikës 8.8.2.1 shtohet pika 8.8.2.2 me përmbajtje si më poshtë:

“8.8.2.2 Furnizimi i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, që kanë karakter terapeutik, si dhe të domosdoshëm për arritjen e qëllimeve terapeutike të synuara nga hospitalizimi dhe kujdesi mjekësor ndaj shtetasve, janë furnizim i tatueshëm me shkallën tatimore 10 për qind.

Në këto shërbime përfshihen:

a) Furnizimi i shërbimeve të kujdesit spitalor, të kujdesit shëndetësor parësor, shërbimi i urgjencës mjekësore, ekzaminimet mjekësore terapeutike të siguruara nga ana e institucioneve spitalore, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe të diagnostikimit (klinika dhe qendra shëndetësore), publike dhe private.

b) Furnizimet e shërbimeve shëndetësore të kryera në kuadrin e profesionit të tyre nga stomatologët, përfshirë dhe furnizimet me proteza, si pjesë e furnizimit të shërbimit stomatologjik ndaj personit, vetëm për qëllime të kujdesit shëndetësor.

c) Shërbimet e analizave mjekësore, kimike për diagnostikim, analizat mjekësore parandaluese në kuadër të kujdesit mjekësor të ofruar nga një institucion shëndetësor i njohur si i tillë.

ç) Shërbimet e ofruara në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë profesionale si mjek ose profesione të tjera mjekësore të licencuara si të tilla, të cilat bëhen për qëllime të kujdesit për shëndetin.

d) Ekzaminimet mjekësore për lëshimin e certifikatave mjekësore të aftësisë për personat, kur këto shërbime synojnë të mbrojnë shëndetin.

Trajtohen me shkallë tatimore prej 20%:

a) Analizat biologjike të kryera në kuadrin e kërkimit të atësisë;

b) Lëshimi i certifikatave mjekësore për vlerësimin e dëmeve trupore të pësuar (veprim gjyqësor) etj.;

c) Shërbimet e ofruara nga veterinerët në ushtrimin e profesionit të tyre;

ç) Shërbimet e kryera nga qendrat e trajtimit të bukurisë, masazheve, shërbime e trajtime estetike, kozmetike, rekonstruktive, nga institucione shëndetësore, publike apo private, apo institucione të tjera të licencuara për këtë qëllim;

d) Shërbimet e ofruara nga individë, të cilët aplikojnë metoda jotradicionale trajtimi mjekësor.”.

8. Pas pikës 8.13 të udhëzimit shtohet pika 8.14 me përmbajtjen si më poshtë:

“8.14. Furnizimi i shërbimeve arsimore

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore, publike dhe private, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), duke filluar nga data 1 tetor 2010, është furnizim i përjashtuar.”

Në kuptim të ligjeve të sipërcituar konsiderohen furnizim i shërbimeve arsimore, furnizimet e mëposhtme:

3. Furnizimi i shërbimit të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, nga institucione të arsimit të lartë, si: universitetet, akademitë, kolegjet profesionale, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare, përveç furnizimeve të tjera që kryejnë këto institucione në kuadër të veprimtarisë së tyre studimore, shkencore të cilat janë furnizime të tatueshme me TVSH.



4. Furnizimi i shërbimeve arsimore të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në nivele të ndryshme shkollore e parashkollore (arsimi bazë; arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional, arsimi special, kopshtet).

5. Furnizimi i shërbimeve arsimore që kryhen nga institucionet arsimore plotësuese jopublike, që funksionojnë jashtë strukturave të institucioneve arsimore, publike e private dhe ku punohet në drejtim të arsimimit e të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta (p.sh. kurse kualifikimi specifike), brenda ose jashtë planeve mësimore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.”.

9. Në pikën 9.2, titulli “Kartat telefonike të parapaguara”, zëvendësohet me “Kartat me parapagim”;

Në paragrafin e parë, fjalia e parë, riformulohet si më poshtë:

“Operatorët kryesorë të komunikacioneve dhe operatorët kryesorë të transmetimeve televizive tokësore dhe satelitore, llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave të parapaguara që ata u furnizojnë distributorëve të tyre.

Në paragrafin e dytë, fjalia e dytë, shprehja “distributorët e kartave telefonike të parapaguara” zëvendësohet me shprehjen “distributorët e kartave të parapaguara”.

10. Në pikën 9.5.3 “Rregulla të përgjithshme”, pas pikës “e” shtohet pika “f” me përmbajtjen:

“f. Furnizuesit e ndërmjetëm dhe të gjithë furnizuesit e mëpasshëm të cigareve, përfshirë njësitë e shitjes me pakicë, janë të detyruar të dokumentojnë të gjitha shitjet e cigareve të kryera me fatura tatimore apo kupon tatimor fiskal në varësi të skemës së aplikuar. Këta furnizues janë të detyruar t’i regjistrojnë, evidentojnë në librin e shitjes dhe në librin e blerjes transaksionet e shitblerjes së cigareve, në përputhje me kërkesat ligjore të këtij udhëzimi dhe procedurat tatimore në fuqi.

Si furnizime jashtë objektit të TVSH-së, evidentimi dhe regjistrimi i këtyre faturave në librin e blerjeve dhe të shitjeve do të bëhet në rubrikat “Shitje e përjashtuar” dhe “Blerje pa TVSH” dhe do të deklarohet në rubrikat respektive të formularit të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së, pa ndikuar në TVSH-në e pagueshme dhe në kreditimin e tatimit.”

11. Pas pikës 9.5 “Furnizimi i cigareve” shtohet pika 9.6 “Trajtimi i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“9.6 “Trajtimi i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike”

Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike, “humbje gjatë transportit të energjisë elektrike” do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje, që miraton Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Për efekte fiskale, niveli i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike është vjetor dhe niveli maksimal i humbjeve është përqindja e miratuar çdo vit nga ERE.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve tejkalon përqindjen e miratuar nga ERE, për efekte fiskale konsiderohet përqindja e miratuar nga ERE.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve është më e ulët se përqindja e miratuar nga ERE, për efekte fiskale konsiderohet përqindja faktike e humbjeve.

Brenda tre muajve të vitit pasardhës, tatimpaguesi që operon në sektorin e shpërndarjes së energjisë në bashkëpunim me administratën tatimore kryejnë rakordimet përkatëse.”.

12. Pas pikës 10 “Eksportet” shtohet pika 10.1 me këtë përmbajtje:

“10.1 Trajtimi i rasteve kur produktet e eksportuara nga eksportues shqiptar, refuzohen dhe kthehen nga blerësi i huaj, përveç rasteve që i nënshtrohen regjimit të përpunimit aktiv.

10.1.1. Mallra që i kthehen subjekteve shqiptare shitëse (eksportuese) nga blerës të huaj

Në këtë rast, për vlerën që i korrespondon sasisë së mallit të kthyer, shitësi (eksportuesi) përpilon një notë krediti me vlerën përkatëse të mallit që kthehet, që i drejtohet blerësit të huaj dhe ku referohet saktësisht fatura me të cilën është bërë shitja e mallit që kthehet dhe deklarata doganore përkatëse e importit. Shitësi (eksportuesi shqiptar) është i detyruar t’i kthejë blerësit pagesën, në përputhje me dispozitat kontraktuale, kundrejt vlerës së përcaktuar në notën e kreditit, transaksion i cili duhet të kryhet nëpërmjet bankës. Malli i refuzuar nga blerësi kthehet në Shqipëri, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Doganor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, i shoqëruar edhe me

dokumentacionin përkatës të lëshuar nga blerësi që refuzon dhe kthen mallin. Në këtë rast shitësi (eksportuesi) përgatit një faturë tatimore saktësuese ose anuluese (me minus) të cilën e regjistron në librin e shitjeve të TVSH-së për periudhën tatimore (muajin) në të cilin është lëshuar kjo faturë saktësimi, duke reduktuar shitjet dhe TVSH-në e atij muaji. Faturës saktësuese ose anuluese i bashkëngjitet nota e kreditit.

Shitësi (eksportuesi shqiptar), mund të gjejë një blerës tjetër, po jashtë vendit, duke mundësuar që malli të shkojë direkt nga blerësi i parë tek i dyti, pa qenë i nevojshëm kthimi i mallit në vendin e origjinës (Shqipëri). Procedura e notës së kreditit e lëshuar nga shitësi për blerësin e parë dhe e faturës tatimore të saktësimit (me minus) e lëshuar nga shitësi për blerësin e parë dhe regjistrimi në librin e shitjeve të TVSH-së të shitësit (eksportuesit) është e njëjtë si në paragrafin paraardhës. Në të njëjtën kohë, shitësi (eksportuesi shqiptar) përpilon një faturë tatimore shitje për blerësin e dytë (me TVSH 0%), pa e shoqëruar me deklaratën e eksportit (sepse malli tashmë nuk eksportohet nga Shqipëria). Kjo faturë regjistrohet normalisht në librin e shitjeve të TVSH-së si eksport me vlerën që malli i shitet blerësit të dytë. Transferrat përkatëse monetare, pra kthimi i shumës përkatëse ndaj blerësit të parë që refuzoi mallin dhe arkëtimi i parave nga blerësi i dytë kryhen nëpërmjet bankës.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.394/4, datë 11.11.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.308, DATË 8.5.2009 “PËR PAJISJEN ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, të ndryshuar, të nenit 6 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar dhe ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”,

Me qëllim unifikimin dhe standardizimin e procedurave që ndiqen nga zyrat e gjendjes civile, kompania “ALEAT”, strukturat e Policisë së Shtetit, për pajisjen e shtetasve me pasaportë biometrike, në funksion të parandalimit të veprimtarisë kriminale që lidhet me falsifikimin, shpërdorimin e detyrës etj., dhe të vënies para përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës,

UDHËZOJ:

Pas pikës 2 të udhëzimit nr.308, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“Shtetasit shqiptarë, që aplikojnë për pasaportë biometrike për çdo herë, duhet të pajisen me formular identifikimi me fotografi nga komisariati i policisë ku kanë vendbanimin, i cili plotësohet në dy kopje. Formulari i identifikimit miratohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Kopje e formularit të plotësuar dhe të verifikuar nga policia i paraqitet punonjësit të gjendjes civile pranë zyrës së aplikimit. Kopja e këtij formulari bëhet pjesë e dokumentacionit shkresor sipas pikës 2 të këtij udhëzimi.”

Pas pikës 16 shtohet:



Udhëzimi nr.394, datë 3.11.2011 “Mbi procedurat e pajisjes me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.249, datë 26.10.2011

PËR REVOKIMIN E URDHËRIT NR.92, DATË 27.2.2009 “PËR LICENCIMIN E AGJENCIVE TË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE SHQIPTARË TË FONOGRAMEVE DHE VIDEOGRAMEVE (AMI)”

Në vijim të shkresave nr.407/1 prot 4.10.2011, si dhe shkresës nr.407, datë 17.3.2011 “Relacion mbi veprimtarinë e agjencisë AMI”, të dërguar nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, mbi kundërligjshmëritë dhe parregullsitë e konstatuara në veprimtarinë e kësaj agjencie,

konstatova se:

Në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar, është kompetencë e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve revokimi i licencës së kësaj agjencie. Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 121 dhe të pikës 1 të nenit 124 të Kodit të Procedurave Administrative,

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr.92, datë 27.2.2009 “Për licencimin e agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të prodhuesve shqiptarë të fonogrameve dhe videogrameve (AMI)”.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Aldo Bumçi

VENDIM
Nr.99, datë 30.9.2011

MBI MIRATIMIN E STUDIMIT PËR BORXHIN E KEQ

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “f”, të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 5.2 të deklaratës rregullatore, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.12, datë 3.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2011, pasi analizoi studimin e borxhit të keq dhe nivelet aktuale të borxhit të keq për vitin 2008, 2009, dhe 2010 të paraqitur në ERE nga “CEZ shpërndarje”, relacionin e përgatitur nga grupi i punës që ka analizuar studimin e borxhit të keq,

dhe konstatoi se:

Më datë 29.7.2011 “Cez shpërndarje” sh.a në funksion të veprimtarisë së shitjes me pakicë që ajo kryen paraqiti studimin mbi borxhin e keq të përgatitur nga “Deliotte”, një nga ekspertët e pavarur të listuar në deklaratën rregullatore sipas pikës 5.2.

Studimi i paraqitur bazohet në aplikimin e metodës së të ardhurave dhe të metodës së bilancit, si dhe kombinimin e tyre për të caktuar nivelin aktual të propozuar për vitet 2008, 2009, 2010.

Në studimin e borxhit të keq të përgatitur nga eksperti i pavarur vërehet:

- Përkeqësimi i llogarive të arkëtueshme

Gjatë periudhës 2008-2010 raportohet një normë e lartë mosarkëtimi që ka ardhur gjithnjë në rritje ku nivelet aktuale të borxhit të keq të përcaktuara nga studimi për këtë qëllim, rezultojnë si vijon:

- 2008: 18.39%

- 2009: 20.71%

- 2010: 23.27%

Raporti nuk përmban asnjë analizë lidhur me përkeqësimin e llogarive të arkëtueshme i cili paraqitet si borxh i keq.

- Mosvlerësimi i borxhit të keq në përputhje me kërkesat ligjore

Neni 9 i ligjit nr.10 116 datë 23.4.2009 “Mbi miratimin e Marrëveshjes së privatizimit të 76% të aksioneve të OSSH sh.a.” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë dhe CEZ A.S.” përcakton se:

“në lidhje me vlerësimin e borxhit të keq të OSSH-së dhe në veçanti në lidhje me pikën “c” të nenit 24 të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Mbi tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, njohja nga Enti Rregullator i Energjisë, i nivelit të borxhit të keq, me qëllim llogaritjen e tarifave për konsumatorët fundorë, konsiderohet si evidencë që konfirmon se kompania ka ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimet e borxhit të keq dhe kjo njohje përcakton nivelin e borxhit të keq për qëllime tatimesh”.

Sa më sipër, informacioni mbi procedurat ligjore të ndërmarra gjatë kësaj periudhe për debitorë të veçantë që nuk kanë performancë, duhet të ishte pjesë e studimit të borxhit të keq, sepse për efekt të detyrimeve tatimore, miratimi nga ERE i niveleve të borxhit të keq do të tregojë që: “të gjitha procedurat ligjore për arkëtime” janë ndërmarrë nga ana e kompanisë.

- Përfshirja e borxhit të keq për institucionet buxhetore dhe jobuxhetore

Në studimin e borxhit të keq një sasi e konsiderueshme e llogarive të arkëtueshme ka lidhje me shumën të detyrimeve të shtetit ose subjekteve të kontrolluara nga shteti, duke përfshirë klientët buxhetorë dhe ata jobuxhetorë. Duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të këtyre llogarive të arkëtueshme, përfshi këtu edhe mundësinë për kompensim apo pagesë në të ardhmen, siç edhe ka treguar eksperiencën e 10 viteve të fundit, nuk mund të llogaritet provigjion i borxhit të keq për llogari të arkëtueshme të tilla.

- Mosanalizimi i faktorëve që përcaktojnë pagesat nga subjektet private dhe familjare

Në studimin e borxhit të keq, norma e mosarkëtitimit varion në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet rajoneve të shpërndarjes. Eksperti i pavarur nuk ka analizuar faktorët që përcaktojnë nivelet e pagesave, dhe nuk i ka ndarë këta faktorë në faktorë që janë nën kontrollin e kompanisë dhe ata që janë jashtë kontrollit të kompanisë. Në studimin e borxhit të keq nuk jepen hollësi mbi masat e marra nga menaxhimi i kompanisë për të siguruar grumbullimin e të ardhurave të papaguara.

Përveç deklaratës rregullatore dhe manualit të llogarive rregullatore, mungon analiza e akteve të tjera rregullatore (p.sh. kontratat e furnizimit me energji për klientët tariforë) të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në vlerësimin dhe përlllogaritjen e borxhit të keq. Furnizimi me energji i konsumatorëve që nuk paguajnë rregullisht, pa marrë masat e nevojshme operative dhe ligjore, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e nivelit të borxhit të keq. Në studimin mbi borxhin e keq nuk ka një vlerësim lidhur me efektin pozitiv të shitjes me kredi në rritjen e shitjeve dhe të të ardhurave, siç përcaktohet në përkufizimin e llogarive të pambledhshme pika 8.1 e manualit të llogarive ku përcaktohet:

“Llogaritë e pambledhshme do të trajtohen si shpenzime të shitjes me kredi. Arsyeja për këtë është se dhënia e kredive konsiderohet një ngjarje që rrit shitjet dhe të ardhurat. Kompanitë janë shpesh të gatshme të pësojnë humbje nga debitorët e këqij që do të rezultojnë të paarkëtueshëm nëse efekti neto për biznesin është rritja e shitjeve dhe fitimeve.”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin në parim të studimit të borxhit të keq me korrektimet si më poshtë:
 - a) Metodologjia e llogaritjes së borxhit të keq është një vlerësim i llogarive të arkëtueshme, që merr parasysh edhe:
 - Kategorinë e debisë sipas llojit të konsumatorit (buxhetore, jobuxhetore, private etj);
 - Moshën e debisë së konsumatorit;
 - Periudhën e furnizimit të konsumatorëve debitorë;
 - Performacën e kompanisë për mosrëndimin e tarifës së shitjes së energjisë elektrike me kosto të detyrimeve të papaguara.
 - b) Nivelet aktuale të borxhit të keq, me korrektimet e mësipërme, për vitet 2008, 2009, 2010 janë respektivisht 14%, 14% dhe 13 %.
 - c) Borxhi i keq do të llogaritet si përqindje mbi shumën e të ardhurave të furnizuesit publik me pakicë sipas pikës 5.2 të deklaratës rregullore.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “Cez shpërndarje” sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.100, datë 30.9.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC LANABREGAS

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Lanabregas” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Lanabregas.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.101, datë 30.9.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “HEC LANABREGAS”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1, germa a, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.p.k., plotëson kryesisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin teknik (nenin 9 pika 4.10) që ka të bëjë me sasinë e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar; kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e aktivitetit dhe listën e kontratave të mëparshme të realizuara, nuk është dhënë asnjë informacion nga ana e subjektit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.102, datë 30.9.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE ME SERI PM09SH, NR.77, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.23, DATË 25.3.2009 PËR SHOQËRINË KESH SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pika 2 germa “c”, pika 4 germa “a” dhe “b”, 17 pika 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “KESH” sh.a. për ndryshimin e licencës nr.77, seria PM09SH, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.23, datë 25.3.2009 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "KESH" sh.a., plotëson kërkesat ligjore, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.
- Neni 15, pika 4, germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr.77, seria PM09SH, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.23, datë 25.3.2009 për shoqërinë “KESH” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.103, datë 17.10.2011

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (HEC FAQEKUQ 1 DHE HEC FAQEKUQ
2) SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues “HEC “Faqekuq 1 dhe Faqekuq 2”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hp Ostrovica Energy” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , germa “a”, “b”, “c”, “d”.

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”.

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impianteve prodhues Hec “Faqekuq 1” dhe “Faqekuq 2”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.104, datë 17.10.2011

**PËR TRANSFERIMIN E ASETIT TË “SELCA ENERGY”, PËRKATËSISHT
“HEC - SELCA” (LËNIE PENG TË ASETIT SI KOLATERAL PRANË BANKËS CREDINS)**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të asetit të shoqërisë “Selca Energy” për lënie peng të asetit si kolateral pranë Bankës Credins, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,



konstatohet se:

- Aplikimi i shoqërisë “Selca Energy” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, si më poshtë:
 - Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2: Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).
 - Neni 7, pika 1.3, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”: Përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.).
 - Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e asetit të shoqërisë “Selca Energy” sh.p.k. duke pranuar lënien peng si kolateral Hec – Selca, pranë Bankës Credins.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM Nr.105, datë 17.10.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERMA MP” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERMA MP” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatohet se:

- Aplikimi i shoqërisë “ERMA MP” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ERMA MP” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Çarshovë” me fuqi 1.5 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.106, datë 17.10.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERMA MP” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 13 dhe 14 pika 1, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ERMA MP” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ERMA MP” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ERMA MP” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 14.11.2011
Doli nga shtypi më 14.11.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë